



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:264935

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05872816

KPPP.nr.2061/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbaremore të kreditorit “Edona Group” SH.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 811272096 me adresë në rr. “Tahir Sinani”, kundër debitorit “Andi Group 2004” SH.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 811291046 me seli në Gjilan, rr. “Abdullah Tahiri”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Avdulla Gashi, avokat nga Gjilani, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.1497/23 të datës 19.10.2023 të Përmbaremit Privat Atip Mustafa, me seli në Vushtrri, jashtë seancës me datës 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Andi Group 2004” SH.P.K., i ushtruar ndaj Urdhrit P.nr.1497/23 të datës 19.10.2023 të Përmbaremit Privat Atip Mustafa.
- II. Urdhri Përmbaremore P.nr.1497/23 i datës 19.10.2023 i lejuar nga Përmbaremi Privat Atip Mustafa, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaremi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Edona Group” SH.P.K., ka lëshuar Urdhrit Përmbaremore P.nr.1497/23 të datës 19.10.2023 me të cilin e ka lejuar përmbaremit në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës me nr.100-2/25335, Faturës me nr. 100-2/25336 me datë 22.03.2023, Faturës me nr.100-2/25337 me datë 22.03.2023, Faturës me nr.100-2/25495, më datë 29.03.2023, Faturës me nr.100-2/25496 me datë 29.03.2023, Faturës me nr. 100-2/25677 me datë 05.04.2023, Faturës me nr.100 2/25854 me datë 12.04.2023, Faturës me nr.100-2/25855 me datë 12.04.2023, Faturës me nr.100-2/25856 me datë 12.04.2023,

Faturës me nr. 100-2/26081 me datë 26.04.2023, Faturës me nr.100-2/26216, me datë 03.05.2023, Faturës me nr.100-2/26219 me datë 03.05.2023, Faturës me nr. 100-2/26751 me date 24.05.2823, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t'ia paguaj borxhin në shumën prej 1,460.61€ me kamatë ligjore prej 8% nga dita e rënies në vonesë deri në pagesën definitive si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore. Të gjitha këto detyrime duhet të realizohen përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit të hapura në bankat komerciale dhe bartjen e tyre në llogarinë bankare apo përmes përmbarimit dhe sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen të bëhet inkasimi i borxhit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor debitori ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor me arsyetimin se faturat si dokument i besueshëm në bazë të së cilave është iniciuar procedura përmbarimore nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm, pasi që të njëjtat nuk janë pranuar, nënshkruar vulosur nga debitori, andaj të njëjtat nuk mund të konsiderohen dokument i besueshëm. Tutje pretendon se kreditori ka vepruar në kundërshtim me marrëveshjen që ka pasur me debitorin për furnizim me mallra. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi prapësimin e debitorit si të bazuar si dhe ta anuloj urdhrin përmbarimor. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: "LPP") gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: "*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*", ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të njëjtit nen parashihet se: "*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*". Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: "*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të*

besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata vlerëson se Urdhri Përmbarimor P.nr.1497/23 i datës 19.10.2023 bazohet në dokumente të besueshme, përkatësisht Faturën me nr.100-2/25335, Faturën me nr. 100-2/25336 me datë 22.03.2023, Faturën me nr.100-2/25337 me datë 22.03.2023, Faturën me nr.100-2/25495, më datë 29.03.2023, Faturën me nr.100-2/25496 me datë 29.03.2023, Faturën me nr. 100-2/25677 me datë 05.04.2023, Faturën m25496e nr.100 2/25854 me datë 12.04.2023, Faturën me nr.100-2/25855 me datë 12.04.2023, Faturën me nr.100-2/25856 me datë 12.04.2023, Faturën me nr. 100-2/26081 me datë 26.04.2023, Faturën me nr.100-2/26216, me datë 03.05.2023, Faturën me nr.100-2/26219 me datë 03.05.2023, Faturën me nr. 100-2/26751 me date 24.05.2823, të gjitha në lartësi prej 1,460.61€ të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në to janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Për më tepër, gjykata gjen se faturat mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit.

Po ashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbarimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkëngjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Ndërsa, lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim në lidhje me shkeljen e marrëveshjes nga kreditori, gjykata vlerësoi se ekzistimi apo jo i marrëveshjes midis palëve nuk është objekt shqyrtimi në këtë procedurë përmbarimore, pasi që kjo procedurë është formale dhe gjykata shqyrton vetëm përshtatshmërinë e dokumentit mbi bazën e së cilit është iniciuar procedura përmbarimore.

Andaj, në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.2061/23, datë 28.06.2024.

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.